

V E N D I M
Nr. 423, datë 11.6.2001

PËR CAKTIMIN E PAGËS MINIMALE MUJORE NË SHKALLË VENDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për punonjësit, paga bazë minimale mujore në shkallë vendi, e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik dhe fizik, vendas ose i huaj, caktohet 7580 lekë.

2. Vendimi nr.374, datë 14.7.2000 i Këshillit të Ministrave “Për rritjen e pagës minimale në shkallë vendi” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta